



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.93

24 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.606, datë 27.4.2009

Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar 4143

Vendim i KM
nr.700, datë 18.6.2009

Për disa ndryshime në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” 4166

VENDIM
Nr.606, datë 27.4.2009

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të shkronjës “a” të pikës 1 shtohen emërtesat “Punonjësit civilë në Institutin Gjeografik të Ushtrisë, Shtabin e Përgjithshëm, Komandën e Shtabit të Forcës së Bashkuar, Shtabit të Komandës Mbështetëse, Shtabit të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes.”.

2. Në fund të shkronjës “b” të pikës 1 shtohen emërtesat “Shtëpia Botuese e Librit Universitar, punonjësit civilë në Qendrën e Shtypit dhe të Botimeve, Qendrën Kulturore të Ushtrisë, Akademinë e Nënoficerëve “Tomson”, Institutin e Studimeve dhe Projektiveve të Mbrojtjes, Shkollën e Trupës, Arkivin Qendror, Qendrën e Zbulimit Radioteknik, Shtabin e Brigadës së Reagimit të Shpejtë, Brigadës Detare, Brigadës Ajrore, Brigadës së Mbështetjes Rajonale, Brigadës Logjistike, Brigadës së Stërviçjes Bazë, Regjimentit të Helikopterëve, Regjimentit Komando, Regjimentit të Infrastrukturës, Regjimentit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, Komandës së Qendrës së Personel-Rekrutimit, qendrat e riparimit të nivelit të tretë dhe të katërt, të pajisjeve tokësore dhe ajrore dhe në kantierin e ndërtimit të anijeve në Pashaliman.”.

3. Në fund të shkronjës “c”, të pikës 1, shtohen emërtesat “Qendra pritëse e Azilkerkuesve, Babrru, punonjësit civilë të Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura, batalionet në strukturat e Forcave të Armatosura, kompanitë mbështetëse të komandave, brigadave dhe regjimenteve, baza ajrore ndihmëse, në Kuçovë, baza ajrore, Rinas, parku i Veturave, shtëpitë e pushimit të Forcave të Armatosura.”.

4. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Lidhja nr.1/1, që përmendet në pikën 2/1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Lidhja nr.1/2, që përmendet në pikën 2/2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Lidhja nr.1/3, që përmendet në pikën 2/3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Lidhja nr.1/4, që përmendet në pikën 2/4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Lidhja nr.1/5, që përmendet në pikën 2/5, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Lidhja nr.1/6, që përmendet në pikën 2/6, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Pas pikës 2/6 shtohet pika 2/7, me këtë përmbajtje:

“2/7. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Institutin Gjeografik të Ushtrisë, Shtabin e Përgjithshëm, Komandën e Shtabit të Forcës së Bashkuar, Shtabit të Komandës Mbështetëse, Shtabit të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, të jenë sipas lidhjes nr.1/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

12. Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

13.Lidhjet nr.2/1-A dhe 2/1-B, që përmenden në pikën 3/1, të zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

14.Në paragrafin e tretë, të pikës 3/1, vlera “11 000 lekë“ të zëvendësohet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë”.

15.Lidhja nr.2/2, që përmendet në pikën 3/2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

16.Lidhja nr.2/3, që përmendet në pikën 3/3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17.Pas pikës 3/3 shtohen pika 3/4 e 3/5, me këtë përmbajtje:

“3/4. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve civilë në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Qendrën Kulturore të Ushtrisë, të jenë sipas lidhjes nr.2/4-a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve civilë të trupës artistike të Qendrës Kulturore të Ushtrisë të jenë sipas lidhjet nr.2/4-b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr.2/4-b, jepet në masën 2 për qind për çdo vit pune dhe llogaritet mbi vlerën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.

3/5. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve civilë në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Qendrën e Shtypit dhe të Botimeve, Akademinë e Nënoficerëve “Tomson”, Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Mbrojtjes, Shkollën e Trupës, Arkivin Qendror, Qendrën e Zbulimit Radioteknik, Shtabin e Brigadës së Reagimit të Shpejtë, Brigadën Logjistike, Brigadën e Stërvitjes Bazë, Regjimentin e Helikopterëve, Regjimentin Komando, Regjimentin e Infrastrukturës, Regjimentin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, Komandën e Qendrës së Personel-Rekrutimit, qendrat e riparimit të nivelit të tretë dhe të katërt, të pajisjeve tokësore dhe ajrore dhe në kantierin e riparimit të anijeve, në Pashaliman, të jenë sipas lidhjes nr.2/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

18.Lidhja nr.3, që përmendet në pikën 4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

19.Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1.Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve civilë, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura, batalionet në strukturat e Forcave të Armatosura, kompanitë mbështetëse të komandave, brigadave dhe regjimenteve, baza ajrore ndihmëse, në Kuçovë, baza ajrore, Rinas, parku i veturave, shtëpitë e pushimit të Forcave të Armatosura, të jenë sipas lidhjes nr.3/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

20.Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të ministrave të linjës, të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të institucioneve, të përcaktuara në pikën 1, të institucioneve vendore, në varësi të institucioneve rajonale, të punonjësve, që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të bordeve të kullimit, të komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të qarkut, të nëpunësve civilë, në pozicionet mbështetëse “Specialist”, “Shef seksioni” dhe “Përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome, si dhe të punonjësve civilë në qendrat e rekrutimit e të mobilizimit dhe komandat e mbështetjes rajonale të sistemit të Forcave të Armatosura, të jenë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Inspektorët veterinarë kufitarë, inspektorët fitosanitarë kufitarë dhe inspektorët e shërbimit të Inspektoratit Ushqimor, të sistemit të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të cilët bëjnë pjesë në grupet e kontrollit doganor, barazohen në pagë me doganierin e kategorisë C2.”.

21. Lidhja nr.4, që përmendet në pikën 5, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

22. Lidhja nr.4/1, që përmendet në pikën 5/1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

23. Lidhja nr.4/2, që përmendet në pikën 5/2, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

24. Lidhja nr.4/3, që përmendet në pikën 5/3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

25. Lidhja nr.4/4, që përmendet në pikën 5/4, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

26. Lidhja nr.4/5, që përmendet në pikën 5/5, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

27. Lidhja nr.4/6, që përmendet në pikën 5/6, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

28. Pika 5/6, e shtuar me vendimin nr.83, datë 27.1.2009 të Këshillit të Ministrave, numërohet 5/7 dhe ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5/7.Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë, në pozicionet mbështetëse “Specialist”, “Shef seksioni” dhe “Përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome, të jenë sipas lidhje nr.4/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

29. Pas pikës 5/7 shtohet pika 5/8 me këtë përmbajtje:

“5/8. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve civilë, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i insitucionit”, në qendrat e rekrutimit dhe të mobilizimit dhe në komandat e mbështetjes rajonale të sistemit të Forcave të Armatosura, të jenë sipas lidhjes nr.4/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

30. Në pikën 6, vlera “11 000 lekë“ zëvendësohet me “12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë“.

31. Lidhja nr.5, që përmendet në pikën 8, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

32. Në fund të shkronjës “ç” të pikës 8, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, që paguhen sipas lidhjes nr.4/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në rastet kur plotësojnë kushtet për të përfitur shtesë për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, sipas përcaktimeve të pikës 8, nuk do të përfitojnë shtesën e kualifikimit, sipas kolonës nr.3, të lidhjes nr.4/2.”.

33. Pika 11 shfuqizohet.

34. Në fund të pikës 12 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Punonjësit e degëve të thesarit, që punojnë në sistemin AMoFTS, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse”

a) 7000 (shtatë mijë) lekë në muaj për degën e thesarit, Tiranë;

b) 5000 (pesë mijë) lekë në muaj për degët e tjera të thesarit.

Punonjësit civilë në pozicionet “Përgjegjës sektori”, “Kryeinxhinier” dhe “Specialist”, në sektorët e prodhimit dhe të riparimit, në qendrën e ndërtimit dhe riparimit të anijeve patrulluese, për Rojan Bregdetare të Shqipërisë, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, në masën 6000 (gjashtë mijë) lekë në muaj mbi pagën mujore, të kategorisë përkatëse.

Punonjësit civilë në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura, si dhe nëpunësit në pozicionet “Specialist” dhe “Përgjegjës sektori”, në Laboratorin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përfitojnë shtesë, për kushte të vështira dhe të dëmshme për shëndetin. Kjo shtesë të jetë në masën dhe sipas rregullave e kriteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.”.

35. Në pikat 6,7,8,9 e 13 të shtohen fjalët “nr.1/7, nr.2/4-a, nr.2/4-b, nr.2.5, nr.3/1, nr.4/7 e nr.4/8.”.

32. Efektet financiare për këtë vit, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për:

- sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, të përballohen nga fondet e miratuara për vitin 2009, për këtë sistem;

- Shtëpinë Botuese të Librit Universitar, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë institucion;

- të gjitha parashikimet e tjera, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikatat e rritjes së pagave, në ligjin nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET
QENDRORE TË GRUPIT TË PARË**

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	12.000	2%		105.000
Zv/titullar i institucionit	II-b	12.000	2%		88.000
Drejtor Drejtorie Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve Menaxher trajnimi	III-a	12.000	2%		69.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	12.000	2%		60.000
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	12.000	2%		52.000
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000
	IV-b	12.000	2%		31.000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË ZYRËN QENDRORE TË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Kryeregjistruesi	II-a	12.000	2%		105.000	13.000
Zëvendëskryeregjistruesi	II-b	12.000	2%		88.000	13.000
Drejtor Drejtorie	III-a	12.000	2%		69.000	15.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	12.000	2%		60.000	10.000
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	12.000	2%		52.000	5000
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000	10.000
	IV-b	12.000	2%		31.000	5000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	12.000	2%		105.000	10.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	12.000	2%		88.000	8000
Drejtor i drejtorisë së SHKBB	II-b	12.000	2%		88.000	15.000
Drejtor Drejtorie	III-a	12.000	2%		69.000	6000
Përgjegjës sektori në drejtorinë e SHKBB	III-a	12.000	2%		69.000	10.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	12.000	2%		60.000	6000
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	12.000	2%		52.000	0
Specialist/Inspektor në drejtorinë e SHKBB	III-b	12.000	2%		52.000	10.000
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000	5000
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000	0
Specialist	IV-b	12.000	2%		31.000	0

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT,
URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE INFORMALE**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	12.000	2%		105.000	13.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	12.000	2%		88.000	13.000
Drejtor Drejtorie	III-a	12.000	2%		69.000	15.000
Përgjegjës sektori Koordinator	III-a/1	12.000	2%		60.000	10.000
Përgjegjës sektori	III-b	12.000	2%		52.000	5000

Inspektor						
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000	10.000
	IV-b	12.000	2%		31.000	5000

Lidhja nr.1/4

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË AGJENCISË SË KTHIMIT
DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	12.000	2%		105.000	13.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	12.000	2%		88.000	13.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	12.000	2%		60.000	10.000
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	12.000	2%		52.000	5000
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000	10.000
	IV-b	12.000	2%		31.000	5000

Lidhja nr.1/5

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST”
DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË INSTITUTIN E SIGURISË USHQIMORE DHE
VETERINARISË**

PAGA MUJORE						
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	12.000	2%		105.000	
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	12.000	2%		88.000	
Përgjegjës departamenti	III-a	12.000	2%		69.000	
Përgjegjës sektori, në sektorët e përmbajtjes. Drejtor në Drejtoritë Mbështetëse.	III-a/1	12.000	2%		60.000	
Përgjegjës sektori, në sektorët mbështetës.	III-b	12.000	2%		52.000	

Specialist me grada e tituj shkencorë, në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes					
Specialist pa grada e tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes	IV-a	12.000	2%		41.000
Specialist zbatues pa grada dhe tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes. Specialist në sektorët mbështetës	IV-b	12.000	2%		31.000

Lidhja nr.1/6

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Drejtor i Përgjithshëm	II-a	12.000	2%		105.000	12.000
Zv/drejtor i Përgjithshëm	II-b	12.000	2%		88.000	12.000
Përgjegjës sektori në drejtori	III-a/1	12.000	2%		60.000	15.000
	III-b	12.000	2%		52.000	15.000
Përgjegjës sektori mbështetës	III-a/1	12.000	2%		60.000	0
	III-b	12.000	2%		52.000	0
Specialist në drejtori	IV-a	12.000	2%		41.000	15.000
Specialist mbështetës	IV-a	12.000	2%		41.000	0
	IV-b	12.000	2%		31.000	0

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILË NË INSTITUTIN
GJEOGRAFIK TË USHTRISË, SHTABIN E PËRGJITHSHËM, KOMANDËN E SHTABIT TË
FORCËS SË BASHKUAR, SHTABIT TË KOMANDËS MBËSHTETËSE, SHTABIT TË
KOMANDËS SË DOKTRINËS DHE STËRVITJES**

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	12.000	2%		105.000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	12.000	2%		88.000
Përgjegjës departamenti, në Institutin Gjeografik të Ushtrisë	III-a	12.000	2%		69.000
Shef dege të auditimit të brendshëm	III-a/1	12.000	2%		60.000
Përgjegjës/shef sektori. Shef dege Inspektor auditit	III-b	12.000	2%		52.000
Specialist Mjek në strukturat e Forcave të Armatosura	IV-b	12.000	2%		31.000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET
QENDRORE TË GRUPIT TË DYTË**

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit Drejtor Ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit Kancelar në universitet	II-b	12.000	2%		88.000
Zv/titullar i institucionit. Drejtor Drejtorie Ekspert mjeko-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Inspektor në administratën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	III-a	12.000	2%		69.000

Drejtor Drejtorie. Kryeredaktor në Qendrën e Publikimeve Zyrtare Përgjegjës sektori Ekspert toksikologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Ekspert psikiatër-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Ekspert biologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Ekspert mjeko-ligjor pranë gjykatave të apelit Drejtor i bibliotekës shkencore të universiteteve Kancelar në fakultet ¹	III-a/1	12.000	2%		60.000
Përgjegjës sektori. Redaktor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Inspektor Kancelar në fakultet ² Kryetar dege në rektorat	III-b	12.000	2%		52.000
Specialist në administratën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit Kryetar dege në fakultet Përgjegjës biblioteke në universitete dhe shkollat e tjera të larta Përgjegjës sektori në rektorat Përgjegjës sektori në bibliotekën shkencore të universitetit Kryesekretar në universitete dhe shkollat e tjera të larta dhe Shkollën e Magjistraturës Sekretar i kualifikimit shkencor në Shkollën e Magjistraturës Klasifikator dhe kryebibliotekar në universitetet dhe shkollat e tjera të larta Bibliograf në universitete dhe shkollat e tjera të larta dhe Shkollën e Magjistraturës	IV-a	12.000	2%		41.000
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000

¹ Kancelar në fakultetet që kanë fituar autonominë financiare.

² Kancelar në fakultetet që nuk kanë fituar autonominë financiare.

Informaticien (Specialist i teknologjisë së informacionit) i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Informaticien (Specialist i teknologjisë së informacionit) në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Korrektor i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Kurator Inspektor Bibliograf Klasifikator. Bibliotekar Restaurator Lektor Administrator Redaktor Studiues	IV-b	12.000	2%		31.000
Bibliotekar në bibliotekën shkencore të universitetit Bibliotekar në bibliotekën e Fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes Laborant me arsim të lartë në univeresitete dhe shkollat e tjera të larta. Sekretar mësimor Sekretar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	IV-b	12.000	2%		31.000

Lidhja nr.2/1-A

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST”
DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN
KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR DHE NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	12.000	2%		88.000
Zv/titullar i institucionit Drejtor Drejtorie	III-a	12.000	2%		69.000
Përgjegjës sektori	III-a/1	12.000	2%		60.000
Përgjegjës sektori	III-b	12.000	2%		52.000
Specialist	IV-a	12.000	2%		41.000
Mjek	IV-b	12.000	2%		31.000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË
TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT
POPULLOR DHE NË DREJTORINË E TEATRIT TË FËMIJËVE, NË QENDRËN
KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË**

I-Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operas dhe Baletit, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga
1.	Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaestër Baletmaestër Aktor i parë	72.000
2.	Asistentdirigjent Asistentregjisor Solist II (spala sektori) Aktor i dytë	64.000
3.	Orkestrant i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Aktor i tretë Skenograf i kategorisë së parë	53.000
4.	Orkestrant i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Aktor i tretë Skenograf i kategorisë së dytë	43.000

II-Për Drejtorinë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor dhe Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve, në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë

Nr.	Pozicioni	Paga
1.	Dirigjent Regjisor	64.000
2.	Solist i parë Orkestrant i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë	53.000
3.	Solist i dytë Orkestrant i kategorisë së dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë	43.000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST”
DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT”, NË QENDRAT E TRANSFERIMIT TË
TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE**

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			Shtesa e pozicionit
		Paga individuale (paga bazë)			
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	12 000	2%		88 000
Përgjegjës departamenti	III-a	12 000	2%		69 000
Përgjegjës sektori, në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	12 000	2%		60 000
Përgjegjës sektori, në sektorët mbështetës. Specialist me grada e tituj shkencore, në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes.	III-b	12 000	2%		52 000
Specialist pa grada e tituj shkencore në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes	IV-a	12 000	2%		41 000
Specialist zbatues pa grada e tituj shkencore në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes. Specialist në sektorët mbështetës	IV-b	12 000	2%		31 000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË SHËRBIMIN
INFORMATIV USHTARAK**

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			Shtesa e pozicionit
		Paga individuale (paga bazë)			
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	4
Drejtor (titullar i institucionit)	II-b	12 000	2%		88 000
Zv/drejtor operacional Zv/drejtor mbështetës Shef shërbimi operacional	III-a	12 000	2%		69 000
Shef sektori operacional Shef sektori mbështetës	III-a/1	12 000	2%		60 000
Shef zyre drejtori Shef/përgjegjës zyre operacional Shef/përgjegjës zyre mbështetëse Inspektor i përgjithshëm Këshilltar juridik	III-b	12 000	2%		52 000
Specialist Analist	IV-a	12 000	2%		41 000
Inspektor	IV-b	12 000	2%		31 000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST” DERI NË
“TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË QENDRËN KULTURORE TË USHTRISË**

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			Shtesa e pozicionit
		Paga individuale (paga bazë)			
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	4
Titullar i institucionit	II-b	12 000	2%		88 000
Zv/titullar i institucionit	III-a	12 000	2%		69 000
Udhëheqës artistik	III-a/1	12 000	2%		60 000
Përgjegjës sektori	III-b	12 000	2%		52 000
Specialist mjek.	IV-b	12 000	2%		31 000

**STRUKTURA DHJE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË QENDRËN
KULTURORE TË USHTRISË**

Nr	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor	64 000 lekë
2	Instrumentist Vokalist	53 000 lekë

Lidhja nr.2/5

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILE NË POZICIONET “SPECIALIST”
DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË QENDRËN E SHTYPIT DHE TË BOTIMEVE,
AKADEMINË E NËNOFICERËVE “TOMSON”, INSTITUTIN E STUDIMEVE DHE PROJEKTIMEVE
TË MBROJTJES, SHKOLLËN E TRUPËS, ARKIVIN QENDROR, QENDRËN E ZBULIMIT
RADIOTEKNIK, SHTABIN E BRIGADËS SË REAGIMIT TË SHPEJTË, BRIGADËS DETARE,
BRIGADËS AJRORE, BRIGADËS SË MBËSHETJES RAJONALE, BRIGADËS LOGJISTIKE,
BRIGADËS SË STËRVITJES BAZË, REGJIMENTIT TË HELIKOPTERËVE, REGJIMENTIT
KOMANDO, REGJIMENTIT TË INFRASTRUKTURËS, REGJIMENTIT TË MBËSHETJES SË
SHTABIT TË PËRGJITHSHËM, KOMANDËS SË QENDRËS SË PERSONEL REKRUTIMIT, QENDRAT
E RIPARIMIT TË NIVELIT TË TRETË DHE TË KATËRT TË PAJISJEVE TOKËSORE DHE AJRORE
DHE KANTIERIN E NDËRTIMIT TË ANIJEVE PASHALIMAN**

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			Shtesa e pozicionit
		Paga individuale (paga bazë)			
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	4
					Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	12 000	2%		88 000
Zëvendëstitullar Kryeinxhinier në kantierin e ndërtimit të anijeve Pashaliman Drejtor	III-a	12 000	2%		69 000
Kryeinxhinier	III-a/1	12 000	2%		60 000
Përgjegjës sektori Kryeredaktor	III-b	12 000	2%		52 000
Shef zyre Zëvendësshef	IV-a	12 000	2%		41 000
Specialist Redaktor	IV-b	12 000	2%		31 000

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE TË GRUPIT TË TRETË

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit Kapiten i përgjithshëm i kapitenerisë së përgjithshme të porteve	III-a	12 000	2%		69 000
Drejtor drejtorie Zv/kapiten i kapitenerisë së përgjithshme të porteve	III-b	12 000	2%		52 000
Përgjegjës sektori Inspektor	IV-a	12 000	2%		41 000
Specialist Restaurator	IV-b	12 000	2%		31 000
Lektor Arkivist/katalogist Historian	IV-c	12 000	2%		23 000

Lidhja nr.3/1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILË NË POZICIONET “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT”, NË LABORATORIN QENDROR TË FORCAVE TË ARMATOSURA, BATALIONET NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA, KOMPANITË MBËSHTETËSE TË KOMANDAVE, BRIGADAVE DHE REGJIMENTEVE, BAZA AJRORE NDIHMËSE NË KUÇOVË, BAZA AJRORE RINAS, PARKU I VETURAVE, SHTËPITË E PUSHIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejtor i laboratorit	III-b	12 000	2%		52 000
Përgjegjës/shef sektori	IV-a	12 000	2%		41 000
Specialist të kontrollit të hapësirës detare	IV-b	12 000	2%		31 000
Specialist mjek	IV-c	12 000	2%		23 000

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET
RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS, TË INSTITUCIONEVE
RAJONALE/VENDORE, NË VARËSI TË INSTITUCIONEVE TË PËRCAKTUARA NË PIKËN 1, TË
INSTITUCIONEVE VENDORE TË VARËSI TË INSTITUCIONEVE RAJONALE, TË PUNONJËSVE QË
KRYEJNË FUNKSIONE TË DELEGUARA TË PUSHTETIT QENDROR NË PUSHTETIN VENDOR, TË
BORDEVE TË KULLIMIT, TË KOMISIONEVE VENDORE TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË
LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE, PRANË PREFEKTIT
TË QARKUT

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit rajonal Kryetar i zyrës së përmbarimit Drejtor i zyrës vendore të shërbimit të provës Kryetar i degës së thesarit Tiranë Përgjegjës i degëve të thesarit në qendër qarku. Përgjegjës seksioni në seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe. Kryeinspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe	III-b	12 000	2%		52 000
Titullar i institucionit vendor. Përgjegjës sektori në institucionet rajonale. Përgjegjës sektori në degën e thesarit Tiranë. Përgjegjës të degëve vendore të thesarit. Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Përmbarues gjyqësor në zyrat e përmbarimit gjyqësor.	IV-a	12 000	2%		41 000

Specialist në zyrën vendore të shërbimit të provës.					
Përgjegjës sektori i institucionit vendor. Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar) Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar) Specialist në institucionet rajonale Restaurator arti Arkitekt Inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës në qarqe Specialist në degët e thesarit Inspektor pune Inspektor të sistemit të Ministrisë së Bujqësisë	IV-b	12 000	2%		31 000
Specialist në institucionet vendore. Specialist i zyrës së gjendjes civile në komuna (si funksion i deleguar) Restaurator Instruktur Piktor Sekretar deputeti Kontrollor pune	IV-c	12 000	2%		23 000

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË RRETHE

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Regjistrues i Tiranës	III-a	12 000	2%		69 000	15 000
Regjistrues i rretheve të kategorisë së I-rë	III-a/1	12 000	2%		60 000	16 500
Regjistrues i rretheve të kategorisë së II-të. Zëvendësregjistrues i rretheve të kategorisë së I-rë.	III-b	12 000	2%		52 000	16 500
Zëvendësregjistrues në zyrat e kategorisë së II-të	IV-a	12 000	2%		41 000	16 500
Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë	IV-a	12 000	2%		41 000	10 000
Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë së II-të. Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë.	IV-b	12 000	2%		31 000	10 000
Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorisë së II-të.	IV-c	12 000		2%	23 000	6 000

Shënim: Zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë janë zyrat: Tiranë, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Shkodër, Vlorë, Dibër dhe Sarandë.

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DREJTORIVE ARSIMORE RAJONALE
DHE ZYRAVE ARSIMORE**

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejtor i drejtorive arsimore rajonale	III-b	12 000	2%	Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë - 20% Shkalla e parë - 30%	52 000
Drejtor i zyrave arsimore. Përgjegjës sektori në drejtorinë arsimore rajonale	IV-a	12 000	2%	Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë - 20% Shkalla e parë - 30%	41 000
Përgjegjës sektori në zyrat arsimore. Specialist në drejtorinë arsimore rajonale	IV-b	12 000	2%	Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë - 20% Shkalla e parë - 30%	31 000
Specialist në zyrat arsimore	IV-c	12 000	2%	Shkalla e tretë - 10% Shkalla e dytë - 20% Shkalla e parë - 30%	23 000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË DREJTORITË E BURGJEVE DHE
INSTITUCIONET E RIEDUKIMIT NË RRETHE**

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)		
Titullar i institucionit	III-a	12 000	2%		69 000	10 000
Zëvendëstitullar i institucionit	III-b	12 000	2%		52 000	8000

Përgjegjës sektori.	IV-a	12 000	2%		41 000	5000
Specialist	IV-b	12 000	2%		31 000	4000

Lidhja nr.4/4

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE (DREJTORIVE) RAJONALE,
TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE /NDËRTIMEVE
INFORMALE

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Drejtor i zyrës (drejtorisë) rajonale, Tiranë	III-a	12 000	2%		69 000	15 000
Drejtor i zyrave (drejtorive) rajonale të kategorisë së parë Zv/drejtor i zyrës (drejtorisë) rajonale, Tiranë	III-a/1	12 000	2%		60 000	16 500
Drejtor i zyrave (drejtorive) rajonale të kategorisë së dytë Zv/drejtor i zyrave (drejtorive) rajonale të kategorisë së parë	III-b	12 000	2%		52 000	16 500
Përgjegjës sektori në zyrat (drejtoritë) rajonale.	IV-a	12 000	2%		41 000	10 000
Specialist në zyrat (drejtoritë) rajonale	IV-b	12 000	2%		31 000	10 000

Shënim: Zyrat (drejtoritë) rajonale të kategorisë së parë të Aluiznit janë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Shkodër, Lezhë, Korçë, Berat.

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ZYRAVE RAJONALE TË AGJENCISË
SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	III-b	12 000	2%		52 000	16 500
Përgjegjës sektori	IV-a	12 000	2%		41 000	10 000
Specialist në institucionet rajonale	IV-b	12 000	2%		31 000	10 000

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË KOMISIONET VENDORE TË
SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN
BUJQËSORE, PRANË PREFEKTIT RË QARKUT**

Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit	Shtesa për kushte pune
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit pranë Prefektit të qarkut Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë.	III-a	12 000	2%		69 000	
Titullar i institucionit pranë prefektit të qarkut Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kukës.	III-b	12 000	2%		52 000	
Specialist në komisionet vendore pranë prefektit të qarkut Durrës, Elbasan, Fier,	IV-a	12 000	2%		41 000	5000

Korçë, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë						
Specialist në Komisionet vendore pranë Prefektit të qarkut Berat, Dibër, Gjirokastrë, Kukës	IV-b	12 000	2%		31 000	5000

Lidhja nr.4/7

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILE NË POZICIONET MBËSHTETËSE
“SPECIALIST”, “SHEF SEKSIONI” DHE “PËRGJEGJËS/SHEF SEKTORI”, NË DREJTORITË E
POLICISË NË QARQE, KOMISARIATE DHE REPARTE AUTONOME

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Përgjegjës/shef sektori në drejtoritë e policisë së qarkut.	III-b	12 000	2%		52 000
Shef seksioni në drejtoritë e policisë së qarkut, komisarate, apo reparte autonome	IV-a	12 000	2%		41 000
Specialist	IV-b	12 000	2%		31 000
	IV-c	12 000	2%		23 000

Lidhja nr.4/8

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE CIVILË NË POZICIONET “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT”, NË QENDRAT E REKRUTIMIT DHE MOBILIZIMIT DHE KOMANDAT E MBËSHTETJES RAJONALE, TË SISTEMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Pozicioni	Kategoria	Paga mujore			
		Paga individuale (paga bazë)			Shtesa e pozicionit
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Përgjegjës/shef sektori	IV-b	12 000	2%		31 000
Specialist	IV-c	12 000	2%		23 000

POZICIONI	KUALIFIKIMI/GRADA TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Titullar i institucionit	Profesor	30 000
	Profesor i asociuar	25 000
Zëvendëstitullar i institucionit	Doktor i shkencave	20 000
Drejtor drejtorie në institucion	Doktor i shkencave	25 000
Përgjegjës departamenti		
Anëtar i komitetit shtetëror të kulteve		
Përgjegjës sektori	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë/studime specializuese afatgjata	10 000
Menaxher trajnimi		
Inspektor	Studime të thelluara pasuniversitare/master i nivelit të dytë	20 000
Specialist		
Të gjitha pozicionet e tjera në të njëjtën kategori me pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “specialist”, sipas lidhjeve të këtij vendimi.		
Punonjësit e trupës artistike në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operas, baletit dhe Ansambllit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Qendrën Kulturore të Ushtrisë.		
Ekspert Mjeko-ligjor në Institutin e Mjekësisë ligjore.		
Kryeinxhinier në strukturat e forcave të armatosura.		
Ekspert toksikologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore		
Ekspert psikiatër – ligjor në Institutin e Mjekësisë ligjore.		
Ekspert biologo-ligjor në Institutin e Mjekësisë ligjore.		
Ekspert Mjeko-ligjor pranë gjykatave të apelit		
Inspektor në administratën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.		
Kancelar në universitet.		

Shënim: Vlerat 20 000 lekë, për diplomat “Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare” dhe 25 000 lekë, për gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, aplikohen për nëpunësit që i kanë përfituar diplomat përkatëse në universitetet, apo shkollat e larta të vendeve të përcaktuara sipas listës që i bashkëlidhet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Financave dhe Departamentit të Administratës Publike.

VENDIM
Nr.700, datë 18.6.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR,
NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 2 të kreut II “Paga bruto dhe paga minimale”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 16 120 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 80 600 (tetëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.”

2. Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 13 e 14 të kreut III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve, për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 4 497 (katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë. Kontributi minimal mujor, sipas degëve të sigurimit, të jetë:

	%	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	48;
Dega e sigurimit të barrëlindjeve	1.4	226;
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	3482;
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	48;
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	145;
Sigurimet shëndetësore	3.4	548.

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarit dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të jetë 7% e pagës minimale mujore, e barabartë me 1128 (një mijë e njëqind e njëzet e tetë) lekë.

3. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për të punësuarin, duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 27.9% e pagës bruto mujore, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 16.7% dhe pjesa e të punësuarit 11.2%. Kontributet llogariten nga punëdhënësi, mbi pagën bruto, të përcaktuar në këtë vendim. Ai mban nga paga e punëtorit 9.5%, për sigurim shoqëror, dhe 1.7% për sigurim shëndetësor, dhe, së bashku me pjesën e tij 15% të pagës, për sigurim shoqëror, dhe 1.7% të pagës, për sigurim shëndetësor, e deklaron dhe e paguan në llogarinë bankare, të përcaktuar për kontributet.

4. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 26.7% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 15.6% dhe pjesa e të punësuarit 11.1%, por jo më pak se niveli minimal i pagës bruto, të përcaktuar për llogaritjen e kontributit.

5. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 1 javë, duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 3.7.% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 2% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, por jo më pak se niveli minimal i pagës mujore, të përcaktuar për llogaritjen e kontributit.

6. I vetëpunësuarit, i vetëpunësuarit në ortakëri, i vetëpunësuarit që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30% (23%, sigurim shoqëror dhe 7% sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale, prej 16 120 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) lekësh, të barabartë me 4836 (katër mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj. Këta persona llogarisin kontributet për vete dhe për pjesëtarët e familjes, që nuk trajtohen me pagë, dhe i paguajnë në llogarinë bankare, të përcaktuar për kontributet.

7. I vetëpunësuarit, për pjesëtarët e familjes së vet, mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.5.2009 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind sigurim shoqëror dhe 7 për qind sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 16 120 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) lekësh, e barabartë me 4836 (katër mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, sipas përcaktimeve në këtë vendim, nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 1200 (një mijë e dyqind) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia, që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.5.2009 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 16 120 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 14 400 (katërmëdhjetë mijë e katërqind) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 9360 (nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë.

13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore, për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, sipas përcaktimit në shkronjën “g” të pikës 1 të këtij vendimi, të jetë 1200 (një mijë e dyqind) lekë në muaj.

14. Kontributi i detyrueshëm për aksidente dhe sëmundje profesionale, për kohën e formimit profesional, të personave të punësuar në subjekte, që punojnë me material të porositësit, të jetë 0,3 për qind e pagës bruto minimale, dhe paguhet totalisht nga punëdhënësi.”.

3. Kapitulli VIII “Shuma bazë e përfitimeve”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kapitulli VIII

Shuma bazë e përfitimeve

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.5.2009 e në vazhdim, të jetë 10 276 (dhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit, për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, nga data 1.5.2009 e në vazhdim, është 6344 (gjashtë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuar në bujqësi, nga data 1.5.2009 e në vazhdim, është 6344 (gjashtë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë në muaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.5.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 24.6.2009
Doli nga shtypi më 24.6.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë